



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A.nr. 342/2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nihat Idrizi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 08.12.2010, mori këtë:

## V E N D I M

**MIRATOHET** ankesa si e bazuar.

Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 3500 (tremijëpesqind) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Lëvizja Vetëvendosja, ka parashtruar ankesë më të cilën pretendon se subjekti politik AAK, ka bërë shkelje të nenit 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*, sepse subjekti politik AAK, i ka mbuluar posterat e Lëvizjes Vetëvendosje, duke e vendosur posterin e kandidatit për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, Shkelzen Jusaj.

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 06.12.2010, nga Lëvizja Vetëvendosja, në të cilën theksohet se me 06 dhjetor 2010 në ora 17:00 në rrugën UÇK në Prishtinë anëtarët e subjekti politik AAK kanë vendosur posterin e kandidatit për deputet Shkëlzen Jusaj mbi posterat e Lëvizjes Vetëvendosje, e që është në kundërshtim me nenin 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi, në të cilën shihet qartë se posterin e kandidatit për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, Shkëlzen Jusaj, nga radhët e subjektit politik AAK, është vendosur mbi posterin e Lëvizjes Vetëvendosje. Parashtruesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore.

### **Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:**

PZAP-i e informoi subjektin politik AAK, më datë 07.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 08.12.2010, gjerë në ora 12:00. PZAP-i, nuk pranoi përgjigjeje në ankesë nga subjekti politik AAK, brenda afatit të caktuar.

### **Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike**

Dispozita ligjore e Neni 33 pika (a) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërsi si në vijim:*

*a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posterit ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;*

### **Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve**

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

*Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:*

*c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).*

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se posterit i kandidatit për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, Shkëlzen Jusaj, nga radhët e subjektit politik AAK, është vendosur mbi posterin e Lëvizjes Vetëvendosje. Prandaj nga këto arsye dhe më qëllim të evitimit të shkeljes së lartcekur po ashtu në pajtim më dispozitat e lart cekura

ligjore, PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar, e lidhur me nenin 115.1 të LZP-së,  
vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 342/2010 më datën 08.12.2010

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**

